



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIK OF KOSOVO  
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 45 /2014  
Datë: 25 shkurt 2014

Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 4 paragrafi 1.13 dhe 1.14 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 25 shkurt 2014 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti i Njësitit për shqyrtimin e Performancës së Prokurorive lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e Korrupsionit, verifikimi dhe mbikëqyrja e të dhënave të futura në mekanizmin përcjellës ( data bazë).
- II. Këshilli Prokurorial i Kosovës aprovon Konstatimet dhe Rekomandimet të propozuara nga komisioni në raport.
- III. Këshilli Prokurorial i Kosovës, kërkon nga Kryeprokuroret e Prokurorive Themelore dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin masa në adresimin e çështjeve që dalin nga konstatimet dhe rekomandimet e Komisionit.
- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës kërkon nga Kryeprokuroret e Prokurorive Themelore dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin masa adekuate ligjore ndaj të gjithë personave përgjegjës që nuk kanë kryer obligimet e tyre lidhur me futjen e të dhënave në mekanizmin përcjellës (data bazë) për harmonizimin e raporteve statistikore dhe obligimet që dalin nga plani i veprimit për ngritjen e efikasitetit të sistemit prokurorial në luftimin e Korrupsionit.
- V. Kryeprokuroret e PTH dhe PSRK të përgatisin raportet me shkrim për masat e ndërmarra për KPK
- VI. Obligohet Sekretariati për publikimin e këtij Vendimi në ueb faqen e KPK-së.
- VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Ismet Kabashi  
Kryetar i Këshillit Prokurorial

T'i dërgohet:

- Kryeprokurorit të Apelit;
- PSRK;
- Kryeprokurore të PTH;
- Sekretariatit të ZKPSH dhe NJSHPP;
- Arkivit të PSH-së.